



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 4, DATË 07 / 05 /2024

PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “BLUE BAY RESORT” ME SUBJEKT APLIKUES
RINIA - 04 SHPK NUIS K52622408F

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e një strukture akomoduese, ku do të ketë një hotel me 300 dhoma, me ambiente shërbimi si bare dhe restorante, ambiente rekreative si pishina dhe ambiente çlodhje, zona të gjelbëruara, parkim, në Bashkinë Himarë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 24,400,000 Euro (njëzet e katër milion e katërqind mijë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 100 punonjës.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar zënë një sipërfaqe totale 22, 100 m² në ZK Nr. 1952 dhe më konkretisht përbëhen nga pasuritë me nr 11/677, nr. 1/812 dhe nr. 1/714, pronë private.
- Projekti realizohet nga subjekti Rinia - 04 shpk me NUIS K52622408F.

- Për subjektin “Rinia 04” shpk është miratuar leje zhvillimi për objektin “Strukturë Hotelerie 1 - 4 kate, me vendndodhje në Livadh, Bashkia Himarë” me vendimin Nr. 16, datë 10.06.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Blue Bay Resort”, me subjekt investues Rinia - 04 shpk NIPT K52622408F, ZK 1952, Bashkia Himarë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti i propozuar bie ndesh me parashikimet e Ligjit Nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”, i ndryshuar, pasi lloji i pasurive “pemtore” dhe “ullishte” në të cilat synohet të zhvillohet projekti i investimit nuk lejon ndërmarrjen e veprimtarisë së kërkuar nga subjekti.
3. Në këtë zonë vazhdon procesi i regjistrimit të Akteve të Marrjes të Tokës në Pronësi / Përdorim (AMTP), në referencë të ligjit nr 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si pasojë nuk ka informacion lidhur me rregjistrimin e këtyre AMTP-ve.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)**